



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education, and Science  
Zyra e Sekretarit të përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Numër: 2/1K 3783  
Datë: 29.12.2020

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të nëpunësve publik dhe ankesa tjera i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), në bazë të **nenit 11, paragrafi 2, i Ligjit nr. 06/L - 113** për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 19, 9 shtator 2011), Udhëzimit administrativ për ndarjen e bursave nr. 14/2017 i dt. 06.12.2017, si dhe Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm, **Nr.2-235, dt.14.02 2020**, Vendimin e Ministrisë nr 01B/123 si dhe bazuar në **nenin 132 paragr. 1, neni 26 paragr. 2,3 dhe neni 27 paragr. 1** të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me Shqyrtimin e Ankesave për Bursat Elitare të Universiteteve Publike për vitin akademik 2020/2021 nxjerrë:

**V E N D I M**

1. **APROVOHEN ANKESAT** si të bazuara të studentëve me **nota elitare** të Universiteteve Publike për vitin akademik 2020/2021, drejtuar Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të nëpunësve publik dhe ankesa tjera i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).
2. Obligohet divizioni i financave për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me procedurat dhe afatet ligjore.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Nr.	Emri biemri	Nr. i Ankesës	Universiteti	Niveli	Nota mesatare	
1	Bleona Islami	3390	Fak. Edukimit	Bsc	9.36	
2	Duart Nishefci	3452	FSHMN	Bsc	9.22	
3	Llukman Ilazi	3689	Fak. Turizmit dhe Ambientit	Master	9.90	
4	Edlira Dibrani	3730	Fak. Filologjik	Master	9.43	

5	Enkeleda Gashi	3731	Fak. Filologjik	Master	9.71	
6	Arjete Dodaj	3540	Fak Filozofik	Bsc	10.00	
7	Kujtim Shala	3491	Fkulteti i Arteve	Bsc	9.24	
8	Uran Rakovica	3469	Fakulteti i inxhierisë Elektrike	Master	9.07	
9	Lorik Kallaba	3459	Fak Ekonomik	Master	9.58	
10	Rilind Maloku	3470	Fak. Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	Master	9.27	
11	Agon Beka	3653	Fak Juridik	Bsc	9.70	

### ARSYETIM

Palët e lartshënuar, kanë parashtruar ankesë pranë Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtresave, me Nr. të protokollit të cilat janë të evidentuar në listën më lartë, me arsyetim së i njëjtit kanë plotësuar kriteret e përcaktuara nga MASH-i, notën mesatare mbi 9.00 dhe provimet e përfunduara të vitit, sipas shpalljes publike ‘Konkursit’ të datës 20.10.2020 për ndarjen e bursave dhe kriterëve të përcaktuara në Udhëzimit administrativ për ndarjen e bursave nr. 17/2017 i dt. 06.12.2017, si dhe ‘Konkursit’ të datës 20.10.2020 të shpallur për ndarjen e bursave

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtresave, në cilësinë e Organit Epror, në përputhje me **nenin 132 paragr.1 neni 26 paragr. 2,3 dhe neni 27 paragr. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative** dhe Udhëzimin Administrativ Për ndarjen e Bursave nr. 14/2017 i dt. 06.12.2017, ka marrë lëndët në shqyrtim, me qëllim të zgjidhjes së ankesës.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtresave, pas shqyrtimit dhe analizës së lëndëve dhe dokumentacionit të bashkangjitur; Formularët e Aplikacioneve, Certifikatat e lindjes, Vërtetimin e statusit të studentit/es, Certifikatën e vërtetuar të notave nga fakultetet gjegjëse-Administrata.

Komisioni konstaton se vërtetohet se, aplikuesit i plotësojnë kriteret për marrjen e bursës. Të njëjtit ka notën mesatare mbi 9.00-provimet e mbaruara në afatin e përcaktuar në shpalljen publike ‘Konkursit’, dhe gjithë dokumentacionin që vërtetojnë plotësimin e kriterëve; Formularët e Aplikacioneve, Certifikatat e lindjes, Vërtetimin e statusit të studentit/es, Certifikatën e vërtetuara të notave nga fakultetet gjegjëse-Administrata.

Kështu, studentët në listën e shënuar më lartë, i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara nga MASH-i në shpalljen publike si dhe kriteret e përcaktuara në Udhëzimit administrativ për ndarjen e bursave nr. 14/2017 i dt. 06.12.2017, nenit 8, paragrafi 1.

Prandaj bazuar në të dhënat e lartshënuara, Komisioni e aprovon Ankesat e tyre me këtë Vendimi, cili do të bëhet publik në WEB faqen zyrtare të MASH-it

### Këshillë Juridike;

Kundër Vendimit të Komisioni për Ankesa të nëpunësve publik dhe ankesa tjera të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), palët e pa kënaqura e cila pretendon se Vendimi i Komisionit nuk është i ligjshëm, mund të inicioj procedurë të ‘Konfliktit Administrativ’ pranë Gjykatës Themelore Departamenti përkatës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita a pranimit të Vendimit.

Prishtinë, më 28.12.2020.

## Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave-MASH

### **Vendimi u dërgohet:**

Sekretarit të Përgjithshëm-MASH;  
Kabinetit të Ministrit-MASH  
Departamentit të Arsimit të Lartë  
Divizionit për Financa  
Anëtarëve të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave  
Arkivit.

Agim KRASNIQI  
Kryetar i Komisionit /MASH

